



Pranuar / Dorezuar Prilicjen / Predato Received / Delivered		23 . 10 2020	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojt e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTHCK	2222/2020		1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A. Nr. 254/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Ilire Mehmeti - Shaqiri Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A. Nr.254/2020 të datës 28.08.2020 të parashtruar nga [REDACTED] nga Komuna e Pejës, kundër Vendimit me numër reference 228/2020 të datës 17.06.2020 të Ministrisë së Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës, lidhur me pezullimin parandalues, si dhe Vendimit me numër protokoll 94/2020 të datës 17.08.2020 të Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, lidhur me sistemimin e përkohshëm, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23/10/2020, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Detyrohet** Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të bëjë shqyrtimin e ankesës me numër protokoll 1060 të datës 26.06.2020, të parashtruar nga ankuesi [REDACTED], si dhe të gjitha pretendimet tjera të mëvonshme të cilat ndërlidhen me këtë lëndë, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- II. Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që ti ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që zbatimi i këtij vendimi të bëhet brenda afatit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## Ar sy e t i m

Drejtori i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, [REDAKTUAR], me datë 26.06.2020, ka parashtruar ankesën me numër protokoll 1060 pran Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kundër vendimit me numër reference 228/2020 të datës 17.06.2020, për pezullim parandalues me pagesë 50% të rrogës, për shkelje të supozuara të detyrave të punës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 16.07.2020, ka nxjerr njoftim me shkrim përmes të cilit e ka njoftuar ankuesin se nuk mund ta shqyrtoje këtë lëndë për faktin se kjo procedure është në mandatin e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe se kjo çështje duhet të vendoset nga Këshilli për Pozita të Nivelit të Lartë Drejtues.

Me datë 17.08.2020, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka nxjerr Vendimin me numër protokoll 94/2020, përmes të cilit ankuesin [REDAKTUAR] e ka sistemuar përkohësisht në pozitën e punës "Udhëheqës i Departamentit për Çështje Konsullore" në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Pas refuzimit të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, për trajtim të rastit, Ankuesi [REDAKTUAR], kundër vendimit me numër reference 228/2020 të datës 17.06.2020 për Pezullim parandalues, si dhe Vendimin me numër protokoll 94/2020 të datës 17.08.2020 për sistemim të përkohshëm, me datë 28.08.2020 përmes e-mailit zyrtar ka parashtruar ankesën me numër protokoll 1879/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.09.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Me datë 17.09.2020 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr.254/2020 të datës 28.08.2020, me numër protokoll 1650/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me numër protokoll 1060 të datës 26.06.2020 drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në MPJ; Vendimin me numër reference 228/2020 të datës 17.06.2020 për pezullim parandalues me 50% të pagës; Vendimin nr.94 të datës 17.08.2020 për sistemimin e përkohshëm; Emailin zyrtar të datës 20.10.2020 të Menaxheres së Personelit në MPJ; Akt Emërimit nr.097 të datës 13.12.2012; Akt Emërimit nr.97/2013 të datës 23.10.2013; Akt Emërimit nr.097 të datës 21.07.2016; Vendimin nr.1-2020 të datës 14.10.2020 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për zgjatjen e afatit të vendosjes; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 1794/2020 të datës 17.09.2020 me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka mandat ligjor për trajtimin e kësaj lënde.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në Akt Emërimin me numër të aktit 097 të datës 21.07.2016 ka konstatuar së ankuesi ██████████ është i punësuar në pozitën e punës Drejtor i Përgjithshëm në kuadër të Drejtorisë së Përgjithshme - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Akt emërimi me numër të aktit 097 i datës 21.07.2016 është lëshuar në bazë të Rregullores Nr.07/2010 për Emërimin e Nëpunësve Civil, si zyrtar i karrierës me afat të pa caktuar.

Bazuar në nenin 5 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimet e Jashtme, dhe dispozitat e nenit 6 të Rregullores Nr.04/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Ministrin e Punëve të Jashtme, Kolegji për vendosjen dhe shqyrtimin e ankesave, vlerëson së pozita e Drejtorit të Përgjithshëm nuk hynë në listën e pozitave të kategorisë së lartë drejtuese, sepse kjo pozite nuk është përgjegjëse për menaxhimin e përgjithshëm administrativ të institucionit të administratës publike në shërbimin civil, siç përcaktohet me nenin 4 paragrafi 1 nenparagrafi 1.1 të Rregullores Nr.05/2012 për Klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. Andaj, Kolegji vlerëson së Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka mandat për trajtimin e kësaj lënde, konform Rregullores Nr.05/2011 për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në nenin 83 paragrafi 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik, vlerëson së procedurat disiplinore dhe procedurat e ankesave dhe kontesteve të cilat kanë filluar në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, do të vazhdojnë sipas dispozitave të atij ligji, përveç nëse vlerësohet nga pala së është më e favorshme procedura e ligjit të ri, por aplikimi i ligjit të ri mund të bëhet vetëm me kërkesë të palës.

Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas konstatimit se kjo procedure ka filluar sipas dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës, duke u bazuar në nenin 131 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës, nenit 83 paragrafi 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik, si dhe nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mori vendim që lënda ti kthehet për vendosje Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Ligjin Nr. 03/L-122 për Shërbimet e Jashtme të Republikës së Kosovës, neni 2 përcakton se: *Anëtarët e shërbimit të jashtëm"- janë anëtarët e përhershëm të Ministrisë si dhe anëtarët e Ministrisë të caktuar në misione diplomatike dhe konsullore në shtete të tjera dhe në organizata ndërkombëtare.* Ndërsa Ligji Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimet Diplomatie të Republikës së Kosovës, neni 8 përcakton se: *Anëtarët e Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përveç të emëruarve politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjore me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes efektive të punës së ambasadave dhe misioneve ose zyrave tjera jashtë Kosovës.* Bazuar në këto dispozita ligjore, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, vlerëson se Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, shqyrtimin e kësaj lënde duhet ta bëjë konform legjislacionit të aplikueshëm për Shërbimin Civil, dhe rregullave të veçanta të Shërbimit të Jashtëm.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

*Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës*

*Lënda Nr. A. Nr. 254/2020*

**Ilire Mehmeti-Shaqiri**

**Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional**



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit [REDACTED]
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

